



DY FJALË MBI FILOSOFINË ISLAME

Edin Q. Lohja

Filosofia islame përbën një nga shpalosjet më të lavdishme të trashëgimisë së stërpasur shpirtërore dhe intelektuale të Islamit. Këtë e dëshmojnë qartë mbi 1200 vjet të traditës së vyer filosofike të rrënjëzuar thellë në botëkuptimin e shpalljes kur'anore, në një kosmos ku profetësia pranohet si një realitet verbues, që është burimi i jo vetëm etikës por edhe i ditorisë. Kështu, filosofia islame është islame jo vetëm në sajë të faktit se ajo u kultivua në botën islame nga muslimanët, por sepse ajo i nxjerr parimet, frymëzimin dhe udhërrëfimin e saj si dhe shumë prej çështjeve me të cilat merret, nga vetë burimet e shpalljes islame: Kur'ani Fisnik dhe Hadithi profetik, megjithë pretendimet e zhurmshme të kundërshtarëve të saj që pohojnë të kundërtën.

Shumica e studiuesve perëndimorë të filosofisë islame kanë preferuar t'i identifikojnë shkollat e tjera të mendimit islam si *kelam*-i apo *fikh*-u si islame, kurse filosofinë islame si të "huaj", të "huazuar" dhe "imituese", duke u bërë tërheqës për ata zëra mjermanë brenda vetë botës islame që i janë kundërvënë asaj filosofie.

Filosofia islame nuk është arabe për mjaft arsye. Parasëgjithash, ndonëse shumica e veprave të filosofisë islame u shkruan në arabisht, një pjesë e madhe e tyre u lëvruan në persisht duke u kthyer deri tek Ibn Sina. Së dyti, ndërkohë që mjaft filosofë islamë ishin arabë, si el-Kindi dhe Ibn Rushdi, shumica prej tyre ishin persianë e disa madje edhe me prejardhje turke e indiane. Për më tepër, Persia ka mbetur qendra kryesore e filosofisë islame gjatë shumicës së historisë së Islamit, edhe pas mbylljes së ciklit të filosofisë peripatetike me Ibn Rushdin, duke u ringjallur në shkollat e *ishrak*-ut të Suhrevardit dhe teosofisë transhendentale të Mulla Sadrait e gjer më sot. Filosofia islame u krijua nga muslimanë që ishin arabë, persianë dhe më vonë turq, indianë, malezianë etj. Ajo funksionoi në një univers të mbizotëruar nga shpallja kur'anore dhe shpalosja e natyrës së Parimit Hyjnor të *tewhid*-it. Në një mjedis të tillë, u krijua një traditë filosofike e cila veprroi si katalizator për lindjen e filosofisë mesjetare hebraike dhe pati një ndikim të thellë mbi filosofinë dhe teologjinë në Perëndimin e krishterë.

Filosofia islame reagoi në mënyra të shumta me shkollat e mendimit islam dhe, mbështetur mbi një pjesë të konsiderueshme të urtisë së lashtësisë, krijoi një nga traditat më të pasura në botë, e cila ka mbijetuar si një realitet gjallues edhe sot, duke vazhduar të jetë një aktivitet intelektual madhor.

Të gjithë filosofët islamë që nga el-Kindi e gjer tek ata të ditëve të sotme si 'Alameh Tabataba'i ishin muslimanë dhe jetonin e merrnin frymë në një univers të mbizotëruar nga realiteti i Kur'anit dhe Sunneti i Profetit të bekuar (s). Thuajse të gjithë ata kanë jetuar sipas *Sheri'a*-tit dhe janë falur në drejtimin e Qa'bes, çdo ditë të jetës së tyre. Ibn Sina shkante në xhami dhe lutej kur ndeshej me ndonjë problem të vështirë, ndërsa Ibn Rushdi ishte kadiu suprem i Kordovës. Mulla Sadrai e bëri haxhë shtatë herë në këmbë dhe vdiq gjatë haxhëhit të fundit.

Duhet theksuar, së fundmi, se kuptimi i fjalës filosofi (*felsefeh* ose *hikmeh*) në Islam është ai burimor, tradicional i *filo-sofisë* (nga greqishtja e lashtë: dashuri për urtinë) si edukuese e shpirtit dhe e mendjes me dashurinë për të vërtetën dhe jo thjesht si një aktivitet logjik i arsyes së divorcuar nga drita e intelektit dhe e realizimit të brendshëm. Me filosofi në Islam nënkuptohet kërkimi i urtisë, edukimi i vetes dhe dëshira për

diturinë jo në kuptimin e dijes së thatë, informative dhe dyshimndjellëse, të shprehur në një zhargon abstrakt e të ndërlikuar, tipik për filosofinë moderne, të bazuar në rebelimin e njeriut ndaj Qiellit dhe shpalljes, që reduktohet në akrobaci të arsyes së zhveshur nga intelektin. Filozofia në Islam është e përngjitur me metafizikën dhe rrugët e realizimit shpirtëror; ajo mbështetet në mundësinë e arritjes së dijes së sigurt (*'ilm ul-jekin*). Ajo s'mund të identifikohet kurrsesi me mënyrat përdhosëse apo thjesht racionale të mendimit modern, të cilat fillojnë me dyshim dhe e kufizojnë intelektin të arsyeja (*racio*), e rrjedhimisht nuk është njëloj me filosofinë siç kuptohet në Perëndim, megjithëse ajo i përdor argumentimet racionale dhe ligjet e logjikës.